



NJË PERSPEKTIVË E BESUESHME PËR ZGJERIM DHE ANGAZHIM TË SHTUAR TË BE-SË ME BALLKANIN PERËNDIMOR



1 RRUGA PËRPARA NË LIDHJE ME PERSPEKTIVËN E MUNDSHME 2025

Në vitet e ardhshme, **të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mundësinë të ecin përpara** në rrugët e tyre përkatëse evropiane. Komisioni i vlerëson të gjitha vendet në mënyrë të drejtë dhe objektive, në bazë të **meritave të tyre** dhe me atë shpejtësi me të cilën vendet arrijnë përparim në përmbushjen e kritereve të vendosura.

Kjo kërkon **përpjekje serioze** për reformat kyçe, duke përfshirë **sundimin e ligjit** dhe **të drejtat themelore**, luftimin e **korrupsionit dhe krimin të organizuar**, përmirësimin e funksionimit të **institucioneve demokratike, administratës publike** dhe **ekonomisë**, si dhe nxitjen e **marrëdhënieve të mira fqinjësore** dhe **zgjdhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe**.

2 E ARDHMJA - AFATET INDIKATIVE PËR VITIN 2018



Ky është një ilustrim indikativ i hapave që kërkohen për të përfunduar procesin e pranimit sipas perspektivës 2025 nga Mali i Zi dhe Serbia, të dy vendet që i kanë nisur tashmë negociatat. Ilustrimi është thjesht indikativ dhe i bazuar në skenarin më të mirë, si dhe nuk nënkupton asnjë automatizëm; procesi është dhe do të mbetet objektiv dhe meritore. Ilustrimi shërben për të treguar se sa shpejt duhet të miratohen dhe zbatohen reformat transformuese për ta realizuar këtë skenar. Çdo vend do të vlerësohet në mënyrë të pavarur sipas meritës së vet në përputhje me progresin e arritur në përbushjen e kushteve të vendosura.



2018

Mali i Zi dhe Serbia janë dy vendet me të cilat janë duke u zhvilluar bisedimet e anëtarësimit.



Plotësimi i standardeve të përkohshme

Është jetike të vendoset një fokus edhe më i madh në përbushjen e standardeve të përkohshme në fushën e sundimit të ligjit. Këto kërkesa dhe kushte janë të shkruara qartë nga Komisioni në raportimin e tij të rregullt. Tash, udhëheqësit e vendeve duhet të trajtojnë sfidat ekzistuese me forcë dhe me angazhim më të qartë. Në rastin e Serbisë, duhet të plotësohen standardet e përkohshme në lidhje me normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën (kapitulli 35) dhe urgjentisht të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht e detyrueshme për normalizimin.



Përcaktimi i qëndrimeve të përbashkëta të BE-së në fushat kyçe të politikave

Komisioni do të përgatisë një komunikim me vlerësimet e efektit të anëtarësimit të ardhshëm në fushat kyçe të politikave, si bujqësia, politika e kohezionit dhe buxheti. Kjo do t'u mundësojë shteteve anëtare të përcaktojnë qëndrimet e përbashkëta të BE-së për negociatat e kapitujve përkatës, duke e kuptuar plotësisht ndikimin e mundshëm, si dhe duke përcaktuar çdo masë kalimtare. Zbatimi i parimit të lëvizjes së lirë të punëtorëve në shtetet e reja anëtare është çështje shqetësuese për qytetarët e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor njëkohësisht. Natyra e masave kalimtare në këtë fushë do të duhet të trajtohet në negociata. Në rastin e Serbisë, zbatimi i marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën duhet të ketë përparuar shumë.



Mbyllja e negociatave

Pasi të jenë plotësuar të gjitha standardet e mbylljes për të gjithë kapitujt, duke përfshirë dëshmi të besueshme dhe të qëndrueshme të zbatimit të reformave, veçanërisht në lidhje me sundimin e ligjit, shtetet anëtare do të ishin në gjendje të bien dakord për mbylljen e negociatave të përgjithshme në një konferencë ndërqeveritare. Kjo do të kërkonte përparim të vazhdueshëm dhe të pakthyeshëm në agjendën e reformave. Në rastin e Serbisë, duhet të jetë arritur zbatimi i pakthyeshëm i marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe të detyrueshme ligjore me Kosovën që reflekton konsolidimin e normalizimit të plotë të marrëdhënieve.



Nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit

Pasi vendi apo vendet të kenë përfunduar negociatat, Traktati i Anëtarësimit mund të nënshkruhet pas opinionit të Komisionit, me pëlqimin e Parlamentit Evropian dhe vendimin unanim të Këshillit për pranimit e shteteve të reja anëtare.



Anëtarësimi

Anëtarësimi hyn në fuqi pasi të përfundohet ratifikimi i Traktatit të Anëtarësimit në të gjitha vendet anëtare të BE-së dhe në vendin ose vendet e pranuar, duke marrë parasysh kërkesat përkatëse kushtetuese kombëtare.